



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2023:064871
Datë: 14.11.2023
Numri i dokumentit: 04914732

SCC-11-0001

Paditësi

Xh N nga Prizreni
Përfaqësuar nga avakate M Ç Prizren.

Kundër

E paditura

KBI “Progres – Export” Prizren,
Përfaqësuar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit, rr. “Dritan Hoxha” nr. 55, Lakrishtë, Prishtinë.

Për: Palët

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), Kolegji i përbërë nga Sylejman Shumolli gjyqtar kryesues, Gazmend Sylaj dhe Diellza Hoxha, gjyqtarë, pas seancës dëgjimore dhe seancës vendimmarrëse të mbajtur me 3 nëntor 2023, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- 1. Refuzohet padia e paditësve për shkak të mungesës së legjitimitetit aktiv.**
- 2. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.**

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me 02 dhjetor 2010, Gjykata Komunale ne Prizren me aktvendimin e saj C.nr.338/07 shpalli veten jo kompetente dhe lëndën me të gjitha shkresat e saj e dorëzoi ne Dhomën e posaçme të Gjykatës Supreme. Lënda u regjistrua në Dhomën e Posaçme nën nr. SCC-11-0001.

Paditësi Xh N nga Prizreni me padinë e tij kundër të paditurës KBI “Progres- Export”, kërkon anulimin e kontratës mbi shitblerjen e patundshmërisë leg. Nr. 73/64 date 15 janar 1964 dhe dorëzimin e patundshmërive.

Paditësi pohon se nëna e tij tani e ndjera A N ish nga Prizreni ka qenë pronare e këtyre patundshmërive të cilat janë evidentuar si ngastra kadastrale:

-... ne vendin e quajtur ‘... me kulture e are e klasës se trete ne sipërfaqe prej 38,89 ari e evidentuar sipas flete posedimit ... ZK Lubizhdë,

-... në vendin e quajtur ‘...’ me kulture e arë e klasës se trete në sipërfaqe prej 69,66 ari e evidentuar sipas flete posedimit ... ZK Prizren,

-... në vendin e quajtur ‘...’ me kulture e arë e klasës se trete në sipërfaqe prej 11.94 ari e evidentuar sipas fletë posedimit ... ZK Prizren.

Patundshmëritë e lartcekura janë lidhur nën kushtet e ekzistimit të presioneve dhe të dhunës në të cilat ka qene e rrezikuar ose nuk ka qenë e siguruar siguria e njerëzve dhe pasurisë dhe liria e te drejtat e njerëzve dhe qytetareve në periudhën e shoqërorëzimit të tokave bujqësore për qëllime të formimit të fushës së Prizrenit. Padiësi si i vetmi trashëgimtar i të paditurës gëzon të drejtën që të kërkoj shpalljen nule të kontratës mbi shitblerjen e cila sipas tij është lidhur ne kundërshtim me nenin 8 a) të Ligjit mbi Qarkullimin e Patundshmërive (Fletorja Zyrtare RSS) nr.43/81, e cila zbatohet në tërë Republikën e Serbisë dhe Kosovë, këtë të drejtë padiësi e ka edhe në bazë të nenit 37 të Ligjit Themelor mbi Marrëdhëniet Pronëso-ro-Juridike. Padiësi përmes përfaqësuesit të tij ne padi kërkon nga Gjykata që të caktoj shqyrtimin kryesor, të nxjerr provat e propozuara dhe të aprovoj në tërësi kërkesëpadinë e padiësit Xh N nga Prizreni, të anulohet kontrata mbi shitblerjen e patundshmërive leg. nr. ...e datës 15 janar 1964 e lidhur në mes shitëses tani të ndjerës A N ish nga Prizreni dhe blerësit të paditurës KBI ‘Export Progres’ nga Prizreni. Gjithashtu të vërtetohet se padiësi Xh N nga Prizreni është pronar i vetëm i patundshmërive në fjalë në bazë të trashëgimisë tani të ndjerës, të emës A N dhe të detyrohet e paditura KBI “Export- Progres” nga Prizreni që këtë të drejtë të pranoj padiësit dhe të lejoj që i njëjti të regjistrohet ne librat e kadastrit si edhe të dorëzoj padiësit në shfrytëzim dhe posedim të lirë patundshmëritë në fjalë në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit. Këto pretendime i janë bashkangjitur provat si: Kontrata për shitblerjen e patundshmërisë;

-Çertifikata për ngastrën kadastrale e nxjerrur nga Kuvendi i Komunës se Prizrenit nr. ...-.../08.11.2001;

-Çertifikata e vdekjes nr. ... për A N;

-Çertifikatë e vdekjes nr. ... për A N;

- Çertifikatë e vdekjes nr. ...për Xh N;

- Autorizimi i Avokatit E R;

-Autorizimi i Avokates M Ç nga Prizreni;

-Çertifikata e vdekjes nr. ...për K N;

- Çertifikata e lindjes nr. ...për B N;

-Çertifikata e lindjes nr. ...për B N;

- Çertifikata e vdekjes nr. ...për G O N, etj.

Me 11 dhjetor 2017, Dhoma e Posaçme nëpërmjet urdhrin kërkoj nga përfaqësuesja e padiësve avokate M Q nga Prizreni, padinë e korrigjuar dhe të plotësuar drejtuar Dhomës se Posaçme, Aktvendimin për trashëgimin për tani të ndjerën A N dhe autorizimin për përfaqësim.

Me 15 janar 2018 përfaqësuesja e padiësve u përgjigj duke përmbushur pjesërisht urdhrin dhe ndër të tjera precizoi padinë e padiësve në kuptimin subjektiv.

Me 15 maj 2019, përfaqësuesja e paditësve dorëzoi një propozim për lëshimin e Masës së Përkohshme me shqetësimet se ekziston rreziku që AKP të pamundësoi apo vështirësoi dukshëm realizimin e kërkesës së paditësve sidomos me tjetërsimin e pasurisë së tyre të cilët e kanë në shfrytëzim dhe posedim nga paraardhësit e tyre.

Me 03 qershor 2019 e paditura dorëzoi përgjigjën e saj në lidhje me kërkesën e paditësve për masën e përkohshme ku ndër të tjera thekson se propozimin në fjalë nuk mbështetet në prova dhe se paditësit nuk kanë ofruar arsyetim se nga mos aprovimi i masës së përkohshme atyre do tu shkaktohej demi i pariparueshëm apo i pa kompensueshëm dhe i atëçastshëm në mjete monetare në kuptim të nenit 55.1 Shtojca e Ligjit të Dhomës së Posaçme. E paditura i propozoi gjykatës që të refuzohet propozimi i paditësve për aprovimi e masës së përkohshme.

Me 12 qershor 2019, Dhoma e Posaçme me aktvendimin e saj nr. SCC-11-0001 refuzoi kërkesën e paditësve për masë të përkohshme, ku ndër të tjera arsyetoi se nuk ka rrezik për dëm të menjëhershëm dhe të pariparueshëm pasi e paditura nuk ka ndërmarrë ndonjë veprim konkret me qëllim të tjetërsimit të objektit të kontestit dhe se paditësi nuk e ka bërë të besueshëm faktin se ekziston e drejta e tij e pretenduar dhe se ka gjasa ta fitoj rastin për më tepër paditësit dhe përfaqësuesja e tyre kanë dështuar të dorëzojnë aktvendimin e trashëgimisë që ishte kërkuar nga gjykata për tani të ndjerën A N. Aktvendimi në fjalë ishte apeluar dhe kolegji i apelit në aktvendimin AC-1-19-0103 date 09 gusht 2019 kishte refuzuar ankesën dhe vërtetuar aktvendimin e datës 12 qershor 2019.

Me 26 tetor 2023, Dhoma e Posaçme, në këtë çështje ka caktuar dhe mbajtur një seancë dëgjimore, në të cilën kanë prezantuar përfaqësuesi i palës paditëse dhe përfaqësuesi i palës së paditur.

Përfaqësuesja e paditësve në seancë dëgjimore ka pohuar se mbetet pranë padisë së parashtruar në Gjykatën Komunale të Prizrenit si dhe ka bërë përmirësimin e padisë në kuptimin subjektiv ashtu që tani e tutje si paditës të jenë trashëgimtarët e tani të ndjerës A (A) N e që sipas deklarimeve të saj janë (si në parashtrësën e datës 15 janar 2018):

H (e ve e Xh) N, L (Xh N) L, nga Prizreni,

B (K) N dhe B (K N) M, që të dy nga Gj,

A, B, F dhe F (J N) Sh,

V (e ve e B), A, (B - J N) K, V dhe V (B - J) N, nga Prizreni, dhe

G (G N) O nga Tetova,

M (G N) P nga Tetova,

G (G N) R nga Shkupi dhe

B (G N) O nga Tetova. Gjithashtu përfaqësuesja e paditësve i dorëzon dëshmitë për rast të ngjashëm: si padia për anulimin e kontratës së shitblerjes së patundshmërisë nr.6/91 date 31 maj 1995 Prizren, Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prizren nr. P.br. 451/95 të datës 24 prill 1997 dhe Aktgjykimin nr. GZH 258/98 të datës 31 prill 1998 i Gjykatës së Qarkut në Prizren. Përfaqësuesja e paditësve deklaroi se nuk ka asgjë për të shtuar përveç asaj që i njëjti standard të aplikohet edhe në rastin e palëve që përfaqëson.

Përfaqësuesi i palës së paditur në seancën dëgjimore deklaroi se nuk është e nevojshme që t'i shikoj dëshmitë e dorëzuara sepse kanë mjaftueshëm shembuj të tillë. Në fjalën e tij deklaroi se e konteston në tërësi kërkesëpadinë e paditësve për arsyet të cilat i kishin theksuar edhe më herët me shkrim si në përgjigje në padi dhe në përgjigje të kërkesës për aprovimin e masës së sigurimit. Më tej pohoi se legjitimiteti aktiv i paditësve nuk është rregulluar ashtu siç kërkohet edhe përkundër urdhrin të kësaj gjykate nuk është sjell aktvendimi mbi trashëgiminë, si dhe fakti se kërkesëpadia e paditësve bazohet në një dispozitë ligjore që tani nuk është e zbatueshme në Kosovë. Më tej, në fjalën e tij përfundimtare të dorëzuar me shkrim thekson se gjatë tërë shqyrtimit dhe në seancë dëgjimore u vërtetua fakti se nga provat në të cilat mbështetet padia e paditësit si dhe baza juridike në të cilën bazohet ajo nuk janë relevante për rastin. Pra, paditësi ka dështuar të ofroj dëshmi të besueshme, nga të cilat vërehet se ai është dëmtuar me veprime të kundërligjshme të të paditurës KBI "Progres Export" në Prizren, e përfaqësuar nga AKP. E paditura i propozon gjykatës që të refuzoj në tërësi padinë e paditësit si të pabazuar në ligj.

Për detaje të tjera referimi mund të bëhet në dosjen e lëndës.

Arsyetimi ligjor:

Kërkesëpadia e paditësve refuzohet për shkak të mungesës së legjitimitetit aktiv.

Në bazë të nenit 2.4 dhe nenit 77.1.1.1 të Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejshëm Ligji për Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Neni 76.3 i Ligjit Nr.06-L-086 Për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës parasheh:

Në interpretimin dhe zbatimin e këtij ligji, kudo që është e nevojshme për të zgjidhur një çështje procedurale që nuk trajtohet mjaftueshëm me këtë ligj, Dhoma e Posaçme do të zbatojë mutatis mutandis dispozita përkatëse të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore.

Neni 73 i Ligjit Nr.03/L-006 Për procedurën Kontestimore parasheh se kush mund të jetë palë në procedurën kontestimore.

Në rastin konkret gjykata gjen se me 10 maj 2007 ishte parashtruar një padi në Gjykatën Komunalë në Prizren nga paditësi Xh N nga Prizreni. Pas vdekjes së paditësit, është bërë përmirësimi i padisë në aspektin subjektiv si në parashtrësën e datës 15 janar 2018, ashtu që si paditës janë paraqitur trashëgimtarët e tani të ndjerës A (A) N, e që janë: H (e ve e Xh) N, L (Xh N) L, nga Prizreni, B (K) N dhe B (K N) M, që të dy nga Gjilani, A, B, F dhe F (J N) Sh, V (e ve e B), A, (B - J N) K, V dhe V (B - J) N, nga Prizreni, dhe G (G N) O nga Tetova, M (G N P) nga Tetova, G (G N) R nga Shkupi dhe B (G N) O nga Tetova. Sipas parashtrësës së përfaqësueses së paditëses të datës 15 janar 2018, të njëjtit janë deklaruar se janë trashëgimtarë të paditëses tani të ndjerës A N, por në gjykatë nuk kanë paraqitur ndonjë provë me të cilën do të dëshmonin legjitimitetin real aktiv të tyre. Për tu dëshmuar legjitimiteti real aktiv i paditësve

dhe pasardhësve të tjerë eventuale të të ndjerës A N dhe për të vazhduar procedura në këtë çështje në bazë të dispozitave ligjore, duhet të dorëzohet aktvendimi mbi shqyrtimin e trashëgimisë, me të cilin do të shpallehin të gjithë trashëgimtarët e tani të ndjerës A N.

Legjitimiteti procedural apo e drejta e ndjekjes së çështjes në gjyq në radhë të parë u takon subjekteve të cilët janë pjesëmarrës të raportit materialo-juridik kontestues, pra mund të jenë kreditorë, përkatësisht debitorë të së drejtës të përfshirë me anë të kërkesëpadsisë. Në këtë rast paditësit nuk kanë legjitimitet real aktiv pasi që të njëjtit nuk e dëshmojnë se janë të vetmit trashëgimtarë të të ndjerës A N nga e cila pretendohet se janë marrë parcelat kontestuese në vitin 1964, në kuptim të nenit 178.1 të Ligjit për Procedurën Jokontestimore (Ligji nr. 03/L-007). Pra nga raporti materialo juridik për të cilin ka lindur kontesti vërtetohet se subjekti që tani na paraqitet si palë paditëse nuk ka legjitimitet real aktiv pa dorëzuar aktvendimin për shqyrtimin e trashëgimisë. Gjykata me këtë nuk e mohon faktin se paditësit janë trashëgimtarë të të ndjerës A N, por dispozitat ligjore përcaktojnë që vetëm me dorëzimin e aktvendimin për shqyrtimin e trashëgimisë vërtetohet legjitimiteti i palëve në procedurë.

Me 11 dhjetor 2017, gjykata nëpërmjet urdhrin kërkoi nga përfaqësuesja e paditësve që ndër të tjera të dorëzoj aktvendimin e trashëgimisë për tani të ndjerën A N, por që e njëjta dështoi të përmbush urdhrin në lidhje me këtë çështje, e të cilën nuk e bëri as gjer në kohën e caktimit të seancës dëgjimore të datës 26 tetor 2023, përkundër faktit që ka kaluar një kohë jashtëzakonisht e gjatë.

Me 26 tetor 2023, gjykata ka mbajtur një seancë dëgjimore dhe në të njëjtën u shqyrtuan pretendimet e palëve, ndër të tjera çështja e legjitimitetit aktiv të paditësve për të cilën e paditura theksoi se të njëjtit nuk iu kanë përmbajtur urdhrin të gjykatës dhe nuk kanë dorëzuar aktvendimin për shqyrtimin e trashëgimisë për paraardhësin e tyre. Paditësit nuk e kanë njoftuar gjykatën për përfundimin e procedurave në fjalë, brenda afatit të caktuar në urdhër, as deri me vendosjen e këtij aktgjykimi.

Njëherit gjykata u bënë me dije palëve se padia është refuzuar për shkak të mungesës së legjitimitetit aktiv dhe se kjo nuk paraqet një aktgjykim meritore dhe nuk e bënë çështjen si të gjykuar (res judicata) Pasardhësit e paditëses A N në të ardhmen mund të paraqesin një padi të re, pasi që të shqyrtohet trashëgimia e të njëjtit dhe kështu do të kenë të drejtën e ndjekjes së çështjes në gjyq.

Andaj në bazë të të lartcekurave dhe në pajtim me nenin 54.1 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

Taksat gjyqësore

Në bazë të nenit 62.5 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, secila palë do ti mbulojë shpenzimet e veta.

Këshilla juridike

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Sylejman Shumolli, Gjyqtar kryesues

Gazmend Sylaj, Gjyqtar

Diellza Hoxha, Gjyqtare